



VENDIM

Nr. 67 Datë 27.07.2011

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “DOSKU - ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, neni 15 pika 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 8 pika 4 dhe neni 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dosku –Energy“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, te kesaj shoqerie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g” janë plotësuar plotësisht me përjashtim të kërkesës së gërmës “e” për shkak të mungesës së Çertifikatës së rregjistrimit të pronësisë së subjektit “Dosku-Energy” sh.p.k.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d” janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi i Komisionerëve



Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”, me kusht që: Subjekti “Dosku Energji” sh.p.k të paraqesë Çertifikatën e rregjstrimit të pronësisë branda 2 (dy) vjetesh nga data e dhënies së liçensës.
2. Afati i kohëzgjatjes së liçensës do të jetë 30 vjet.
3. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI